

KARAKTERISTIKAT E MJETEVE RRUGORE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Menaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikëria.....	9
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	11
Aneks	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Energjisë dhe Transportit, Drejtoria e Statistikave Sektoriale
1.3. Personi i kontaktit	Albana Osmënaj
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialiste, Sektori i Statistikave të Energjisë dhe Transportit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	aosmenaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Certifikimi i fundit i metadatës	21.07.2026
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	21.07.2026
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	21.07.2026
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Statistikat mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” japin informacion mbi numrin e mjeteve rrugore që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, të regjistruar me status “aktiv” ose “të çregjistruara përkohësisht” në Regjistrin Kombëtar Shqiptar të Mjeteve Rrugore. Në këtë publikim paraqiten disa tregues mbi mjetet rrugore, të tilla si: • Mjetet rrugore sipas llojit; • Mjetet rrugore sipas qarqeve; • Mjetet rrugore sipas kambios; • Mjetet rrugore sipas vitit të prodhimit; • Mjetet rrugore sipas markës; • Mjetet rrugore sipas lëndës djegëse;

	• Autovetura sipas markës dhe vitit të prodhimit; • Autovetura sipas vëllimit të motorit dhe lëndës djegëse. Publikimi mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” përfshin të dhëna të detajuara lidhur me mjetet rrugore gjithsej, sipas qarqeve si dhe një paraqitje krahasimore me mjetet rrugore deri në vitin 2025, sipas detajimeve përkatëse të tilla si: mjetet rrugore gjithsej, autovetura sipas viteve të prodhimit, autovetura sipas lëndës djegëse dhe autoveturat sipas vëllimit motorrik, autobusë dhe kamionë sipas qarqeve, autobusë dhe kamionë sipas llojit të kambios, sipas moshës, sipas markës, autobusë sipas lëndës djegëse dhe sipas vëllimit motorik.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Të dhënat dhe përkufizimet e përdorura janë në përputhje me Kodin Rrugor si dhe me Manualin e Statistikave të Transportit Rrugor, në mënyrë që të prodhohen statistika të harmonizuara në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar.
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhënat për mjetet e transportit rrugor, që rezultojnë aktive ose të çregjistruara përkohësisht në Republikën e Shqipërisë.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Inventari i mjeteve rrugore: Numri i mjeteve rrugore të regjistruara në një datë specifike në vend dhe të licencuara për të përdorur rrugët me trafik publik. Autoveturë: mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9 (nëntë). Autobus: mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 (nëntë) vende. Kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave. Automjete për transport të përzier (ATP): përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal 9 (nëntë) ndenjës, duke përfshirë dhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit. Automjete për përdorim të veçantë (APV): mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave. Automjete për transport të veçantë (ATV): mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe

	karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi. Ciklomotor: mjet me motor, me dy, tre ose katër rrota. Gjysmërimorkio: mjet motorik i transportit i destinuar për transport pasagjerësh dhe mallrash. Makinë bujqësore: mjet motorik me rrota ose me zinxhir i destinuar për t'u përdorur në bujqësi e pylltari, për transport të mallrave bujqësore. Moto-karro: mjete me tri rrota, të destinuar për transport malli. Mund të kenë deri në dy ndenjësë për njerëzit që merren me transportin, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit. Tërheqës: mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove. CC: njësia matëse e vëllimit motorik të mjeteve rrugore e shprehur në cm³.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore i referohet mjetit rrugor të licencuar për të përdorur rrugët me trafik publik.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin të gjitha mjetet rrugore që rezultojnë aktive ose të çregjistruara përkohësisht në Republikën e Shqipërisë dhe që bëjnë pjesë në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve Rrugore.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Statistikat mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” janë publikuar për herë të parë për vitin referencë 2019.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Të dhënat mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” publikohen në numër dhe përqindje.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Periudha referuese e të dhënave për publikimin mbi "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" është vjetore. Ky raport i përket vitit referencë 2025.

6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore për prodhimin e treguesve për “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” janë: • Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare"; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2022-2026; • Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu për këtë statistikë përdoren disa nga përkufizimet e rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Evropian Nr.70/2012, datë 18 Janar 2012.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Disa tregues mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” transmetohen në Eurostat prej vitit 2016.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti-politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligj Nr. 124/2024 për mbrojtjen e të Dhënave Personale. Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti-trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a. Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b. Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet

	dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vërtetuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses në kalendarin e publikimeve	Kalendar i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34, të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit mujor mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rugore” janë si më poshtë: 1. Website - online release; 2. Kërkesat e shkruara (me postë ose e-mail); 3. Seksioni Kërkesa të dhënash, për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Publikimi “Karakteristikat e Mjeteve Rugore” shpërndahen në bazë vjetore.
10. Akses në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të karakteristikave të mjeteve rugore: • Mjetet rugore sipas llojit; • Mjetet rugore sipas qarqeve; • Mjetet rugore sipas kambios; • Mjetet rugore sipas vitit të prodhimit;

	• Mjetet rrugore sipas markës; • Mjetet rrugore sipas lëndës djegëse; • Autovetura sipas markës dhe vitit të prodhimit; • Autovetura sipas vëllimit të motorit dhe lëndës djegëse. Njoftimi për shtyp mbi "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Të dhënat për publikimin mbi "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" gjenden në faqen e internetit të INSTAT në temën: Industria, Tregtia dhe Shërbimet, Transporti, Aksidentet dhe Karakteristikat e Mjeteve Rrugore .
10.3. Baza e të dhënave online	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat e publikimit mbi "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" janë të vendosura në databazën statistikore, por të dhëna të detajuara mund të gjenden në format Excel ku treguesit kryesorë jepen të detajuar. Këto tabela mund të gjenden në seksionin: Databaza Statistikore .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: Kërkesë të dhënash formulari .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp. Informacion shtesë mbështetës u ofrohet çdo përdoruesi në fund të publikimit. Në faqen e INSTAT, ndodhet një seksion lidhur me metodologjinë e përdorur mbi statistikën për "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore", i cili mund të gjendet në seksionin: Metodologji .
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Energjisë dhe Transportit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018 , INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme,

	me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” krahasohen me të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR) për rakordimin e të dhënave vjetore.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e të dhënave mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” janë si më poshtë: Përdoruesit e jashtëm: • Institucione të administratës publike; • Universitete; • Organizata jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Biznese; • Kërkues shkencorë, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme. Përdorues të brendshëm janë të gjitha ato drejtori dhe sektorë brenda INSTAT që përdorin të dhënat e Karakteristikave të Mjeteve Rrugore për qëllimet e tyre.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit publikohen në faqen e web-it të INSTAT-it, në linkun Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve .
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave për "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" për vitin 2025 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar nga INSTAT nga ato të kërkuara nga rregulloret e ndjekura. Të dhënat janë në përputhshmëri të mirë me Eurostat.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Të dhënat mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” mbledhen në mënyrë administrative në zbatim të bazës ligjore dhe Memorandumit të Mirëkuptimit midis INSTAT dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Nuk kryhen vërtetime për mjetet e transportit rrugor në Shqipëri.

13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.								
14. Afatet kohore dhe përpikëria									
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e statistikave për “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT, 202 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T+202 ditë). Periudha referuese e rezultateve të statistikave për “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” është 31 Dhjetori 2025. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>07/21/2026</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>202</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2025	Data e publikimit	07/21/2026	Afatet kohore	202		
Periudha referuese	12/31/2025								
Data e publikimit	07/21/2026								
Afatet kohore	202								
14.2. Përpikëria	Të dhënat për “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore”, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi për “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100%. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2025</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>07/21/2026</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>07/21/2026</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2025	Data e shpallur	07/21/2026	Data e publikimit	07/21/2026	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2025								
Data e shpallur	07/21/2026								
Data e publikimit	07/21/2026								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria									
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Të dhënat për "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" mbulojnë të gjithë territorin e vendit. Rezultatet që INSTAT prodhon janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat në nivel kombëtar dhe qarku.								
15.2. Krahaseshmëria kohore	Informacioni statistikor grumbullohet në frekuencë vjetore që prej vitit 2019, duke siguruar një krahasueshmëri prej 7 vjetësh, (CC2 = Jlast-Jfirst + 1 = 7). Duke filluar nga viti 2020 janë shtuar dy tregues të rinj, mjete rrugore sipas qarqeve dhe mjete rrugore sipas llojit të kambios. Gjithashtu, janë shtuar edhe detajime për treguesit ekzistues.								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.								

15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet përpara se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet ndërmjet variablave dhe konfirmohet koherenca midis serive të brendshme të të dhënave të ndryshme.
16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i dedikuar për “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” në Sektorin e Statistikave të Energjisë dhe Transportit është: 1 punonjës.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të statistikave mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” hartohen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë, referohuni: • Politika e Revizionimit Statistikor; • Politika e Trajtimit të Gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" për vitin 2025, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burimi i vetëm i të dhënave mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore” është burimi administrativ. Të dhënat grumbullohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Mbulimi i të dhënave është në nivel vendi dhe qarku, dhe informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen me bazë vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat e publikimit mbi "Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor grumbullohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR).
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave të publikimit mbi “Karakteristikat e Mjeteve Rrugore" u kryhen kontrole logjike dhe matematikore. Këto kontrole realizohen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.

18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	